REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot., Tiranë më ____.____.2026

# V E N D I M

**Nr.26, datë 29.10.2026**

**PËR**
**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES NR. 30, DATË 22.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AKEP PËR VITIN 2026"**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---|---|---|
| **Z.** | **Gentian Sala** | **Kryetar** |
| **Znj.** | **Edlira Dvorani** | **Anëtar** |
| **Z.** | **Armer Juka** | **Anëtar** |
| **Z.** | **Bleron Dokle** | **Anëtar** |
| **Znj.** | **Diana Dervishi** | **Anëtar** |

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 29.10.2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren e Brendshme për "Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare" miratuar me Vendimin nr.11, datë 31.03.2026 të Këshillit Drejtues të AKEP, dhe me propozim të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 30, datë 22.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2026".

## BAZA LIGJORE:

1. Pikës 2, të nenit 17 të ligjit nr. 54/2024, datë 30.05.2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
2. Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;

3. Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
4. Udhëzimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare nr. 228, datë 08.11.2017 “Për procedurat e ruajtjes, mbrojtjes dhe kritereve e kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të AKEP”;
5. Vendimit të Këshillit Drejtues, nr. 30, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, për vitin 2026”;
6. Vendimit të Këshillit Drejtues, nr. 33, datë 22.12.2025, “Metodologji për përcaktimin e elementeve përbërës të pagës bruto, vlerës, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet e të punësuarve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”, i ndryshuar;
7. Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.
8. Rregullores së Brendshme “Për funksionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me VKD nr. 11, datë 31.03.2026;
9. Udhëzimi i brendshëm nr. 159, datë 04.08.2026 “Për kriteret, procedurën dhe zbatimin periodik të performancës së punëmarrësve në AKEP”.

**KËSHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projektvendimi i arsyetuar;
2. Relacioni shpjegues i projektvendimit,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar

**V Ë R E N:**

1. Me vendimin nr. 30, datë 22.12.2025, Këshilli Drejtues i AKEP, ka miratuar buxhetin e AKEP për vitin 2026, duke përcaktuar fondet për pagat e personelit, materialet, shërbimet dhe investimet.
2. Me qëllim akordimin e fondit të nevojshëm për shpërndarjen e shpërblimeve për performancë, për vitin 2026, për punonjësit e AKEP; riklasifikimin si investim të fondit të parashikuar për pajisjet e Qendrës së Lëvizshme për Monitorimin e Frekuencave; si dhe financimin e riparimeve teknike kapitale të rrjetit elektrik në godinën e Qendrës Kombëtare të Monitorimit Frekuencave (QKMF), ka lindur nevoja për ndryshimin e pasqyrave 3 “Shpenzime për paga, kontribute dhe të tjera”, 5 “Shpenzime për shërbime” dhe 6 “Shpenzime për investime”, miratuar me VKD nr. 30, datë 22.12.2025.

3. Nevoja për rishikim të fondit të parashikuar për shpërblime për vitin 2026 buron nga fakti se fondi i planifikuar fillimisht për këtë qëllim është reduktuar gjatë zbatimit të buxhetit, si pasojë e mbulimit të efekteve financiare të rritjes së pagave, zbatimit të trajtimit ushqimor dhe ekzekutimit të detyrimeve të paparashikuara që kanë rrjedhur nga proceset gjyqësore me objekt marrëdhënie individuale pune.
4. Nga faktorët e paraqitur më sipër rezulton se zvogëlimi i fondit të disponueshëm për shpërblime lidhet me rritjen e shpenzimeve të përballuara gjatë vitit brenda të njëjtit zë buxhetor. Në këto kushte, nevojitet plotësimi i financimit të këtij zëri, për të mundësuar realizimin e qëllimit për të cilin fondi i shpërblimeve ishte parashikuar fillimisht.
5. Burimi i propozuar për mbulimin e kësaj nevoje janë fondet e lira dhe të paangazhuara në zërin "Shpenzime për shërbime", të parashikuara për realizimin e fushatës së informimit. Realizimi i kësaj fushate ishte i kushtëzuar me hartimin paraprak të strategjisë përkatëse nga një ekspert i jashtëm. Për shkak të dështimit të procedurës së përzgjedhjes të ekspertit, strategjia nuk u hartua dhe fushata nuk u finalizua sipas planifikimit.
6. Rialokimi i propozuar realizohet brenda buxhetit të miratuar të AKEP dhe nuk rrit totalin e shpenzimeve vjetore. Për një institucion me vetëfinancim, kjo ndërhyrje mundëson përdorimin e burimeve ekzistuese për mbulimin e një nevoje konkrete, duke ruajtur ekuilibrin buxhetor. Shpërblimet priten t'i jepen stafit të ndara për 2 (dy) vlerësimet 6 - mujore, respektivisht në muajt nëntor dhe dhjetor 2026.
7. Në buxhetin e vitit 2026, në kategorinë "Shpenzime për shërbime", është parashikuar fondi prej 5,000,000 lekësh me TVSH për zërin "Shërbim i pajisjeve aktuale për Qendrën e Lëvizshme për Monitorimin e Frekuencave (shërbimet e çmontimit, instalimit dhe vënies në funksionim duke shfrytëzuar pajisjet ekzistuese)". Gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit ka rezultuar se ndërhyrja përfshin edhe blerjen e pajisjeve dhe integrimin e tyre në këtë qendër. Për këtë arsye, është kërkuar kalimi i këtij fondi në kategorinë "Shpenzime për investime".
8. Riklasifikimi i propozuar synon përputhjen e planifikimit buxhetor me përmbajtjen teknike të ndërhyrjes dhe trajtimin e pajisjeve e të kostove përkatëse sipas rregullave për aktivet afatgjata, të referuara në relacion. Pajisjet dhe kostot e drejtpërdrejta të instalimit e të vënies së tyre në gjendje pune do të trajtohen në përputhje me natyrën dhe përdorimin e tyre, në masën që plotësojnë kriteret e njohjes dhe të kapitalizimit.
9. Për sa më sipër, vlerësohet i nevojshëm ndryshimi i pasqyrave 5 dhe 6 të buxhetit të miratuar për vitin 2026, për të pasqyruar vlerën e investimit në rrjetin elektrik dhe kalimin e fondit prej 5,000,000 lekësh nga shpenzimet për shërbime në shpenzime për investime. Ndryshimet realizohen brenda fondeve të miratuara dhe nuk sjellin rritje të totalit të buxhetit të AKEP për vitin 2026.
10. Nga diagnostikimi dhe vlerësimi teknik të kryer, janë evidentuar mangësi në sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit elektrik të godinës së Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave, të cilat lidhen me rritjen e ngarkesës elektrike, mungesën e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe mbitensionet, konfigurimin e pajisjeve mbrojtëse dhe organizimin e furnizimit elektrik të sallës së serverëve. Gjithashtu, janë evidentuar anomali në furnizimin me energji elektrike që ndikojnë në funksionimin e pajisjeve të kondicionimit në këtë sallë.

11. Për realizimin e investimit “Riparime teknike kapitale të rrjetit elektrik në godinën e QKMF-së” propozohet parashikimi i një fondi prej 1,770,000 lekësh me TVSH, i cili do të sigurohet nga fondet e lira të rezultuara nga realizimi i zërave të investimeve: “Blerje perde dhe tapet”, në shumën 371,609 lekë; “Blerje mobilje zyre”, në shumën 42,000 lekë; “Përshtatje ambiente zyrat e QKMF për arkivë/protokoll”, në shumën 207,316 lekë; “Supervizime dhe kolaudime”, në shumën 197,885 lekë; dhe “Riparimi i sistemit të kondicionimit në zyrat e QKMF dhe zëvendësimi i sistemit të ftohjes në dhomën e serverave”, në shumën 953,789 lekë, në total në masën 1,772,599 lekë.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Këshilli Drejtues i AKEP,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e pasqyrave 3, 5 dhe 6, në dokumentin e miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 30, datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2026”, sipas tabelave bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| Kryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|---|
| **Gentian Sala** | **Edlira Dvorani** | **Armer Juka** | **Bleron Dokle** | **Diana Dervishi** |